



Nr./Br. 1022-2017

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 64.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe në pajtim me aktivitetet e parapara me Planin Operacional të KQZ-së për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të 11 Qershorit 2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me 09.06.2017 nxjerr këtë:

## VENDIM

### Për Raportimin në Mënyrë Elektronike të Rezultateve Preliminare në Ditën e Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës të 11 Qershorit 2017

- I. Obligohen të gjithë Zyrtaret e Lartë Komunal të Zgjedhjeve (ZLKZ) në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, që Ditën e Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës të 11 Qershorit 2017, lidhur me rezultatet preliminare të raportojnë në mënyrë elektronike vetëm tek personat si në vijim:
  1. Valdete Daka-Kryetare e KQZ-së, në e-mail adresën: [valdetedaka@hotmail.com](mailto:valdetedaka@hotmail.com) dhe [valdete.daka@kqz-ks.org](mailto:valdete.daka@kqz-ks.org)
  2. Enis Halimi - Kryeshef Ekzekutivi i SKQZ-së, në e-mail adresën: [enis\\_halimi@hotmail.com](mailto:enis_halimi@hotmail.com) dhe [enis.halimi@kqz-ks.org](mailto:enis.halimi@kqz-ks.org)
- II. ZLKZ-të e komunave janë të obliguar që pas kontrollimit dhe verifikimit të cilësisë së rezultateve, në afat sa më të shkurtër të mundshëm të njëjtat në mënyrë elektronike t'i përcjellin tek zyrtarët nga pika I e këtij vendimi.
- III. KQZ-ja do të raportojë për daljen e votuesve në zgjedhje dhe do t'i publikojë rezultatet preliminare të zgjedhjeve vetëm për subjektet politike.
- IV. Format e raportimit të rezultateve preliminare i janë bashkangjitur këtij vendimi.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me 09 qershor 2017.

Prishtinë, 09.06.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka

